



IOM International Organization for Migration  
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

## PAKETË INFORMUESE PËR ISH REPUBLIKËN JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

### 1. Informacioni bazë

Kryeqyteti:	Shkup
Popullsia:	2,055,915 (Korrik 2007 est.)
Sipërfaqja:	total: 25,333 km <sup>2</sup> (tokë: 24,856 km <sup>2</sup> ; ujë: 477 km <sup>2</sup> )
Monedha:	Dinar
Niveli i papunësisë:	35% (2007 est.)

### 2. Kushte të përgjithshme të hyrjes dhe informacion për viza

Edhe pse aktualisht Maqedonia ka pak imigracioni, vëmendja politike për këtë çështje, pjesërisht për shkak të mundësive për aderim në BE, frymëzoi për një ligj të ri për të huajt. Ligji, që hyri në fuqi në mars 2007, është në përputhje me kërkesat e BE, si ato që janë për imigracionin.

#### Kërkesat e hyrjes

*Një i huaj mund të hyjë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, nëse ai/ajo:*

- ka një dokument të vlefshëm dhe të njohur udhëtimi;
- ka një vizë të vlefshme, nëse kërkohet;
- ka mjete jetesë për periudhën e qëndrimit të tij/saj, kthimit të tij/saj në vendin nga mbërrin ose kthimin e tij/saj në një vend të tretë ku është i sigurt pranimi i tij/saj ose ai/ajo është në gjendje të sigurojë këto mjete me rrugë ligjore;
- paraqet nëse është e nevojshme, dokumente që justifikojnë qëllimin dhe rrethanat e qëndrimit të tij/saj të planifikuar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë si dhe dokumente për sigurim udhëtimi;
- Nuk është përjashtuar nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe nuk ka ndalim hyrjeje në fuqi dhe nuk paraqet kërcënim për rendin publik, sigurinë kombëtare,

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: "Ngritja e kapaciteteve, Rritja e Shkallës së Informimit dhe Ndërgjegjësimit për Nxitjen e Emigracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor" financuar nga Bashkimi Europian dhe bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin dhe Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë/Zyra Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Qeveria e Lihtenshtein



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra



Federal Office  
for Migration  
and Refugees



GOVERNMENT  
OF LIECHTENSTEIN

shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë

Si **përjashtim**, hyrja mund t'i lejohet një të huaji që nuk plotëson kushtet e mësipërme të hyrjes – bazuar në arsye humanitare, interesa kombëtare ose detyrime ndërkombëtare, të pranuar nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

***Një i huaj mund të hyjë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë pa vizë të vlefshme, nëse ai/ajo:***

- Është shtetas i një vendi me të cilin Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka përfunduar një marrëveshje për heqjen e vizave ose është shtetas i një vendi për të cilin kërkesa e vizës për hyrje dhe kalim nëpërmjet territorit maqedonas është hequr me vendim të qeverisë maqedonase: shtetasit e BH, Serbisë, Kroacisë, Malit të Zi nuk kanë nevojë për vizë. Shtetasit e Shqipërisë kanë nevojë për vizë që të hyjnë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë
- ka shtetësinë e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe është mbajtësi i një dokumenti të huaj udhëtimi, dhe
- Qëndron ligjërisht në një vend me të cilin ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka vendosur një politikë pa viza dhe është nxënës që merr pjesë në një ekskursion shkollor të shoqëruar nga një mësues që ka të përgatitur nga shkolla një listë të nxënësve me të dhënat e secilit prej tyre, si dhe detaje të qëllimit dhe rrethanave të qëndrimit të planifikuar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

***Vizat do të lëshohen sipas aplikimit të një të huaji të dorëzuar në një mision diplomatik ose konsullor të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë jashtë, nëse ai/ajo:***

- ka një dokument të vlefshëm dh të njohur udhëtimi për një periudhë të paktën 3 (tre) muaj më shumë sesa vlefshmëria e vizës;
- me kërkesë të një autoriteti kompetent, ai/ajo dorëzon dokumentacion që konfirmon qëllimin dhe rrethanat e vizitës së planifikuar në ish republikën Jugosllave të Maqedonisë, përfshirë dhe dokumente për siguracion udhëtimi
- me kërkesë të një autoriteti kompetent, ai/ajo dorëzon dokumente që provojnë që ai/ajo ka mjete të mjaftueshme jetesë gjatë qëndrimit të tij/saj në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë si dhe për t'u kthyer në vendin prej nga ai/ajo ka ardhur ose në një vend të tretë ose dokumente që provojnë që këto mjete janë siguruar në çdo mënyrë tjetër të ligjshme;
- nuk përbën rrezik për paqen dhe rendin publik, sigurinë kombëtare, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë
- Nuk ka arsye për refuzim hyrjeje, siç e përcakton neni 23 i ligjit për të huajt; mospërbushja e kushteve për hyrje në Republikën e Maqedonisë siç parashikohet nga ky ligj; ka dyshime të rënda që qëndrimi i tij/saj në vend të lidhet me veprimtari terrorizmi ose veprimtari e krime të tjera të dhunshme; ka ndërmend të kalojë nëpërmjet territorit të Republikës së Maqedonisë, megjithatë ai/ajo nuk plotëson kushtet e hyrjes së një vendi të tretë; nuk ka rimbursuar shpenzimet që lindin nga ndalimi i përkohshëm apo deportimi i tij/saj; ka dyshime të bazuara që ai/ajo do të punësohet ose do të punojë të territorin e Republikës së Maqedonisë në kundërshtim me rregulla e punësimit dhe punës; ka dyshim të bazuara që ai/ajo nuk ka qëllim të qëndrojë në Republikën e Maqedonisë për qëllimin e treguar, ose jep të dhëna të pasakta për veten ose qëllimin dhe rrethanat e udhëtimit ose qëndrimit të tij/saj ose përdor dokumente identifikimi ose udhëtimi të pavlefshme ose të falsifikuara

**Lloji i vizës:**

**Vizë transiti në aeroport (viza A)**- të huajt që nuk largohen nga zona e transitit të aeroportit ndërkombëtar ose janë në bord gjatë qëndrimit të tyre në një aeroport të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nuk i nënshtrohen kërkesës për vizë. Në raste të veçanta, qeveria maqedonase mund të vendosë për nevojën për të plotësuar kërkesat për vizë transiti në aeroport për shtetas të disa vendeve ose udhëtarë që vijnë nga disa rrugë udhëtimi, nëse e kërkojnë interesat kombëtare të mbrojtjes, sigurisë ose marrëdhënieve ndërkombëtare. Viza e transitit në aeroport i jep të drejtën një të huaji të qëndrojë në zonën transit të aeroportit ndërkombëtar derisa ai/ajo të vazhdojë udhëtimin e mëtejshëm me fluturimin ndërkombëtar të radhës.

**Vizë transiti (viza B)**- Vizat e transitit i jepen një të huaji për kalime transit një herë, ose dy herë, në raste të veçanta shumë herë nëpërmjet territorit të Ish republikës Jugosllave të Maqedonisë nga një vend i huaj në një vend të tretë ku ai/ajo mund të qëndrojë për maksimumi 5 (pesë) ditë gjatë çdo kalimi transit të veçantë. Periudha e vlefshmërisë së vizës transit mund të mos jetë më shumë se një vit.

**Vizë qëndrimi afatshkurtër (viza C)**- Viza e qëndrimi afatshkurtër i jepet një të huaji për një ose shumë hyrje në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë kur një qëndrim i vetëm i vazhdueshëm, si dhe koha e plotë të qëndrimit të tij/saj të vazhdueshme në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë **nuk mund të kalojë 3 (tre) muaj në çdo periudhë gjysmë vjeçare** që nga data e hyrjes së parë. Një vizë afatshkurtër lëshohet për një periudhë vlefshmërie deri në një vit. Viza afatshkurtër lëshohet për qëllime turizmi, biznesi, personale ose të tjera. Qëllimi i vizës do të tregohet qartë në vizë.

**Vizë qëndrimi afatgjatë (viza D)**- Viza e qëndrimit afatgjatë mund të jepen për një të huaj që planifikon të qëndrojë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë bazuar në: punësim, punë ose vet-punësim, shkollë ose studime, pjesëmarrje në skema ndërkombëtare për shkëmbimin e studentëve/nxënësve, specializim, trajnim profesional ose trajnim praktik, kërkim shkencor, trajtim mjekësor, bashkim familjar, ose arsye humanitare. Viza jepet për një hyrje në vend dhe siguron qëndrim **deri në 30 (tridhjetë) ditë dhe është e vlefshme për një periudhë deri në 6 (gjashtë) muaj**<sup>1</sup>. Viza do të jepet kur i huaji në fjalë dorëzon një **vendim për dhënie e vizës së përkohshme në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë** të lëshuar nga ministria e punëve të brendshme së bashku me aplikimin e tij/saj për vizë. Një i huaj të cilit i është lëshuar një vizë afatgjatë është i detyruar të paraqitet në Ministrinë e Punëve të brendshme brenda 5(pesë) ditëve që nga data e hyrjes në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë ku Ministria do t'i japë këtij të huaji një leje qëndrimi të përkohshëm brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve nga data e raportimit.

**Vizat e lëshuara në kufi:** Viza transit dhe viza e qëndrimit afatshkurtër që japin të drejtë për qëndrim deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë mund të lëshohen, si përjashtim, në një pikë kalimi kufiri, nëse është e nevojshme për interesat kombëtare të Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë ose bazuar në arsye humanitare, ose nëse parashikohet kështu në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara. Me miratim paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme, viza lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

## Procedura

Viza jepet pasi një i huaj ka dorëzuar aplikimin në misionin diplomatik ose konsullor të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë jashtë. I huaji i interesuar në aplikim duhet të tregojë qëllimin e vizitës së tij/saj në vend, të dorëzojë një dokument të vlefshëm dhe të njohur udhëtimi dhe nëse kërkohet, dokumente të tjera (të përshkruar tek "kërkesat e

---

<sup>1</sup> Kur i huaji është në territori, ai/ajo mund të qëndrojë me këtë vizë D deri në 30 ditë afat kohor ai/ajo duhet të rregullojë qëndrimin e tij/saj pra të marrë një leje qëndrimi të përkohshëm sipas një nga arsyeve të mëposhtme të lejuara: punësim, punë, vetëpunësim, studime, specializim, kërkim shkencor, trajtim mjekësor, bashkim familjar, ose arsye humanitare.

përgjithshme"më lart.) Aplikimi për vizë duhet të përfshijë një fotografi të të huajt të interesuar që paraqet pamjen e tij/saj të vërtetë. Formulari unik i aplikimit për vizës gjendet në: <http://mfa.gov.mk//Upload/ContentManagement/Files/MNR-VisaForm.pdf>

Vendimi për dhënien e vizës merret nga Ministria e Punëve të Jashtme të Maqedonisë. Nëse pozitive, viza jepet nga misioni përkatës diplomatik apo konsullor i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë jashtë. Në raste kur ka dyshim që i huaji përbën rrezik për rendin publik dhe sigurinë kombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme është e detyruar të marrë miratimin paraprak të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në 1 tetor 2008 Ministria e Punëve të Jashtme nisi zbatimin e Amendamenteve të Ligjit për të Huajt dhe Vendimit të Qeverisë për Lehtësimin e Hyrjes në Vend të shtetasve të vendeve anëtarë të BE dhe të vendeve që kanë nënshkruar Marrëveshjen Shengen, shtetasve të vendeve që bëjnë pjesë në listen e bardhe të BE<sup>2</sup> dhe të huajve të cilët kanë vizë Shengen C. Sipas amendamenteve, shtetasit e vendeve antare të BE dhe të vendeve që kanë nënshkruar Marrëveshjen Shengen mund të hyjnë në territorin Maqedon me një dokument të vlefshëm identifikues lëshuar nga autoritetet e autorizuar në vendin e origjinës. Shtetasit e vendeve që bëjnë pjesë në listën e bardhë të BE lejohen të hyjnë në Maqedoni pa vizë. Të huajt që kanë vizë Shengen C mund të hyjnë në vend pa pasur vizë maqedonse dhe koha e qëndrimit përputhet me kushtet e vizës Shengen.

Për **informacion më të detajuar** ju lutemi t'i referoheni Ligjit për të Huajt: <http://www.mvr.gov.mk/EN/Uploads/The%20law%20on%20foreigners.doc>

### 3. Imigracioni për qëllime punësimi

#### Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj

Një i huaj ka nevojë për **leje pune** që të punojë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Leja e punës është dokument në bazë të të cilit punëdhënësi vendas ose i huaj në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë lidh kontratë punësimi ose pune me një të huaj.

#### Llojet e lejeve të punës

a) **Leje personale pune:** leja personale e punës jepet për qëllime vetëpunësimi për një periudhë të caktuar kohore për 1 ose 3 vjet ose për periudha të pacaktuara kohore.

b) **Leje punësimi:** është një formë e lejes së punës që lidhet me nevojën për punësim të përhershëm me punëdhënësit në bazë të organizimit të vendeve të punës. Një i huaj që ka qëndrim të ligjshëm në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe ka një leje të tillë mund të punësohet vetëm nga një punëdhënësi që ka aplikuar për leje pune. Leja e punësimit mund të jepet në bazë të një aplikimi zyrtar dhe nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: punëdhënësi përmbush kushtet e përshkuara me ligj; kuotat e aplikuara për këtë formë punësimi nuk janë plotësuar; punësimi i të huajt nuk ndikon në tregun e punës, sidomos në situatën e papunësisë në vend, në strukturën e punësimit ose në kërkesat rajonale në lidhje me krijimin e vendeve të reja të punës në industri. Në raste që lidhen me atletët, punëtorët në fushën e kulturës, shkencës, redaktorët, stafi i zyrave diplomatike që nuk kanë status të privilegjuar, punësimi i të huajve nuk lidhet me tregun e punës.

<sup>2</sup> Andora, Brunei, Brazil, Kili, Kostarika, Ekuador, Guatemala, Honduras, Meksikë, Nikaragua, Panama, Paraguaj, El Salvador, Singapore, Korea e Jugut, Uruguaj, Hong-Kong, dhe Makao

c) Leje pune: është lloj leje pune me një periudhë kohore të përcaktuar paraprakisht në bazë të të cilës i huaji mund të punojë përkohësisht në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë vetëm për një nga qëllimet specifike të mëposhtme:

- Punë e kryer nga punëtorë të huaj të dërguar;
- Trajnim dhe avancim i të huajve;
- Punë sezonale e të huajve;
- Punë e kryer nga përfaqësues të huaj
- Shërbime individuale nga të huajt.

Një të huaji mund t'i jepet leje pune vetëm në bazë të një aplikimi zyrtar të dorëzuar nga ai/ajo ose punëdhënësi i tij/saj. Çdo qëllim i nënshtrohet një kuote të veçantë të paracaktuar që përcakton vendimet për dhënien e lejes së punës.

### **Procedura**

- Kërkesa për dhënien e lejes personale për punë i dorëzohet Agjencisë Maqedonase për Punësim. Përpara dorëzimit të kërkesës për dhënien e një leje personale pune, i huaji mund të kërkojë informacion (nga Agjencia Maqedonase për Punësim) për kufizime të veçanta për vetëpunësim të të huajve, kuotave etj.
- Kërkesa për dhënien e lejes së punësimit dorëzohet nga punëdhënësi- rezidenti i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ose nga i huaji. Formulari përmban të dhënat e mëposhtme: emrin e kompanisë, adresën; numrin e regjistrimit tek tatimet; llojin e veprimtarisë; të dhëna personale për të huajin në fjalë, adresën e tij/saj dhe llojin e lejes që qëndrimin që ka i huaji. Përpara dorëzimit të kërkesës për dhënien e lejes së punësimit, punëdhënësi mund të marrë informacion për tregun e punës nga Agjencia Maqedonase e Punësimit pra përdorimin e kuotave dhe kufizime të veçanta për punësimin e të huajve siç përcaktohet nga qeveria.
- Nëse aplikoni nga jashtë (jo nga vendi) përpara hyrjes në territorin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, i huaji ose punëdhënësi i tij/saj duhet të dorëzojnë aplikimin për vizë D (për qëllime punësimi, pune ose vetëpunësimi) në Misionin Konsullor ose ambasadën e Maqedonisë në vendin e të huajit (ose ambasadën më të afërt me vendin e të huajit). Aplikimi duhet të shoqërohet me kontratën e punës ose planin e biznesit për veprimtarinë e punësimit që do të krijohet (lëshuar nga punëdhënësi maqedonas ose organizata e krijuar në territorin e Republikës së Maqedonisë). E gjithë paketa e aplikimit i dërgohet MPJ (sistemi i informacionit për vizë), MPJ ia dërgon Seksionit të MB për të Huajt dhe Ripranimet dhe ata ia dërgojnë Agjencisë së Punësimit që jep miratimin për vlefshmërinë dhe justifikimin e veprimtarisë së punësimit të të huajit që do të hyjë në vend për qëllime punësimi

Nëse një i huaj dëshiron të punësohet ose të ketë angazhim profesional apo të studiojë në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, duhet të sigurojë vizën përkatëse (për punësim, angazhim profesional, për studim etj) pranë misionit diplomatik apo konsullor përkatës të Republikës së Maqedonisë jashtë.

Një i huaj duhet të ketë një dokument udhëtimi të vlefshëm dhe gjithashtu të bashkëlidhë një letër nga kompania ku do të punësohet apo angazhohet

Pasi të marrë vizën me shënim "për punësim", "angazhim profesional" apo "për studim" që ka afat 30 ditë, shtetasit e huaj janë të detyruar të hyjnë në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe të dorëzojnë kërkesën për qëndrim të përkohshëm.

### **Faqe interneti për të kërkuar punë**

- Tregu më i madh i punës me njoftime pune nga të gjitha industritë dhe qarqet në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë <http://najdirabota.com.mk/ENG/default.aspx>
- DEKRA përzgjedhja dhe rekrutimi i punëmarrësve - <http://www.dekra.com.mk/eng/index.jsp>
- Motiva- përzgjedhja dhe rekrutimi i punëmarrësve <http://www.motiva.com.mk/>

- Agjencia e Punësimit në Maqedoni <http://www.zvrm.gov.mk/>
- Agjencia për burime njerëzore dhe ndërmjetësim në shërbime punësimi <http://www.vrabotuvanje.com.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1>

## 4. Imigracioni për qëllime studimi

### Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të studentëve

Një aplikim për një leje qëndrimi të përkohshëm për qëllim të frekuentimit në shkollë duhet të dorëzohet nga i huaji tek misioni diplomatik ose konsullor i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë jashtë përpara hyrjes në vend.

Ai/ajo duhet të dorëzojë së bashku me aplikimin sa më poshtë<sup>3</sup>:

- një vërtetim që ai/ajo është një student i shkollës së lartë ose universitetit në një institucion arsimor i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë;
- një kurrikulum të arsimit të parashikuar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë të lëshuar nga institucioni përkatës arsimor në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë që përmban kohëzgjatjen e shkollës ose studimeve si dhe kushtet e regjistrimit për çdo vit vijues ose vit universitar, dhe
- Një vërtetim të njohurive gjuhësore ose të regjistrimit në një kurs gjuhe të përdorur në kurrikulumin e institucionit arsimor në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

Vlefshmëria e lejes për qëllime studimi <sup>4</sup>

Leje e përkohshme për qëllim të pjesëmarrjes në shkollë ose studime jepet për një periudhë deri në **një vit** dhe mund të shtyhet nëse i huaji dorëzon një aplikim për rinovim brenda maksimumi 30 (tridhjetë) ditëve përpara mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit të tij/saj. Gjithashtu, studenti duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të ketë siguruar akomodim ose të ketë mjete financiare për akomodim
- të ketë siguracion shëndetësor
- të ketë një vërtetim të institucionit arsimor përkatës që konfirmon se studenti ka bërë progres në procesin arsimor
- të ketë mjete jetese ose jetesa e tij/saj të sigurohet në mënyrë tjetër të ligjshme
- të mos ketë arsye për refuzim për hyrje (sipas ligjit)

Leja e qëndrimit e përkohshme për qëllim frekuentimin e një shkolle ose për studime mund të shtyhet deri në 1 (një) vit me mbarim të afatit të përcaktuar për procesin arsimor. Me përfundim të shkollës ose studimeve bazuar në kategorinë për të cilën jepet leja e qëndrimit, i huaji në fjalë është i detyruar të largohet nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.

Puna e kryer nga të huajt që qëndrojnë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për qëllim studimi

Të huajt që qëndrojnë në ish Republikë Jugosllave të Maqedonisë për qëllim studimi mund të kryejnë veprimtari afatshkurtra ose ndihmëse pa patur leje pune, nëse periudha e plotë e kryerjes së këtyre veprimtarive zgjat deri në 10 orë pune brenda një jave (leja e qëndrimit për qëllime studimi nuk do të zgjatet nëse i huaji kalon numrin e orëve të punës të përcaktuara me ligj). Organizuesi, klientët ose punëdhënësi në vendin e kryerjes së punës do të jetë i detyruar të regjistrojë punën tek Agjencia e Punësimit. Punëdhënësi do të jetë i detyruar të mbulojë

<sup>3</sup> Ligji për të huajt - neni 59 – Kushtet e dhënies së lejes

<sup>4</sup> Ligji për të huajt - neni 60

shpenzimet për sigurime shoqërore të studentëve të huaj për periudhën e performancës së veprimtarive afatshkurtra ose ndihmëse.

#### **Bursa universitare dhe pasuniversitare**

- Ministria Maqedonase e Arsimit: <http://www.mon.gov.mk/mk/poc>
- Universiteti FON - <http://fonuniversity.com/>
- Universiteti i Europës Juglindore:  
<http://www.seeu.edu.mk/english/news/FinAidOffice.asp>
- Universiteti europian:  
[http://www.eurm.edu.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=1&Itemid=23](http://www.eurm.edu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=1&Itemid=23)

#### **Lista e universiteteve dhe kolegjeve kryesore**

- Universiteti St. Cyril dhe Methodius i Shkupit  
<http://www.ukim.edu.mk/index.php?lan=en>
- Universiteti St. Clement i Ohrit i Bitolës - <http://www.uklo.edu.mk/>
- Universiteti Goce Delčev i Štip - <http://www.ugd.edu.mk/>
- Universiteti FON - <http://www.fon.edu.mk/content.aspx?cid=1>
- Universiteti European i Maqedonisë - <http://www.eurm.edu.mk/>
- Kolegji Universitar Amerikan Shkup - <http://www.uacs.edu.mk/>
- Universiteti Shtetëror i Tetovës  
<http://www.unite.edu.mk/Anglisht/INDEX%20ENG/index1.html>
- Universiteti i Europës Juglindore - <http://www.seeu.edu.mk/english/index.asp>

## **5. Qëndrimi**

### **Qëndrim deri në 3 (tre) muaj**

Qëndrimi i një të huaji që ka ose nuk ka vizë. Një i huaj që është shtetas i një vendi me të cilin ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka vendosur një politikë pa viza mund të hyjë dhe të qëndrojë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për një periudhë deri në 3 (tre) muaj në çdo periudhë gjysmë vjeçare që nga data e hyrjes së parë, nëse ai/ajo plotëson kërkesat e hyrjes të përcaktuara në ligj.

### **Lejet e qëndrimit të përkohshëm (më shumë se 3 muaj)**

Një i huaj duhet të ketë leje qëndrimi të përkohshëm nëse ai/ajo synon të qëndrojë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për më shumë se 3 (tre) muaj, për qëllimet e mëposhtme: punësim, punë ose vetëpunësimi; frekuentim në shkollë ose studime; pjesëmarrje në skema ndërkombëtare për shkëmbimin e studentëve/nxënësve; specializim; arsim profesional ose trajnim praktik; kërkim shkencor; trajtim mjekësor; bashkim familjar; ose arsye humanitare. Leja e përkohshme e qëndrimit mund t'i jepet dhe:

- një të huaji që është anëtar i ngushtë i familjes së një shtetasi maqedonas;
- një të huaji që është me origjinë maqedonase, ose
- një fëmijë të lindur nga një i huaj në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

I huaji të cilit i jepet qëndrim i përhershëm për një qëllim specifik mund të qëndrojë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë vetëm për qëllimin për të cilin i jepet leja.

### ***Kushtet për dhënien e lejeve të qëndrimit të përkohshëm***

Një të huaji mund t'i jepet leje qëndrimi i përkohshëm në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë; nëse ai ka mjete jetese ose jeta e tij/saj sigurohet në mënyrë tjetër të ligjshme; ka akomodim të sigurt ose ka mjete akomodimi; ka sigurim shëndetësor; plotëson kushtet e parashikuara për lloje të ndryshme të lejeve të qëndrimit të përkohshëm dhe nuk ka arsye për refuzim.

### ***Procedura e dhënies së lejeve të qëndrimit të përkohshëm***

Leja e qëndrimit të përkohshëm jepet pas aplikimit të një të huaji që synon të qëndrojë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Aplikimi për qëndrim të përkohshëm do të dorëzohet nga i huaji në misionin e jashtëm diplomatik ose konsullor maqedonas. (në raste të jashtëzakonshme, bazuar në arsye humanitare si dhe në raste të tjera të përcaktuara me këtë ligj, aplikimi për qëndrim të përkohshëm mund të dorëzohet gjithashtu direkt në Ministrinë e Punëve të Brendshme). Misioni diplomatik ose konsullor maqedonas që merr një aplikim për qëndrim të përkohshëm të një të huaji e dërgon aplikimin në Ministrinë e Punëve të Brendshme për vendim përfundimtar. Aplikanti është i detyruar të paraqitet personalisht për intervistë, nëse autoriteti kompetent e kërkon këtë gjë. Një i huaj është i detyruar të dorëzojë një dokument të vlefshëm dhe të njohur udhëtimi ose një kopje të noterizuar të këtij dokumenti të vlefshëm për të paktën 3(tre) muaj më shumë sesa koha e qëndrimit të tij/saj në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë si dhe aplikimin e tij/saj për qëndrim të përkohshëm, si dhe vërtetim që plotësohen kushtet e lartpërmendura për dhënien e lejes të qëndrimit përkohshëm.

### ***Vendimi për dhënien e qëndrimit të përkohshëm dhe të drejtat***

Ministria e Punëve të Brendshme merr vendimin për aplikimet për qëndrim të përkohshëm. Vendimi i jepet të huajit të interesuar nëpërmjet misionit të jashtëm diplomatik ose konsullor maqedonas që merr aplikimin. Kundër vendimit, i huaji ka të drejtë të bëjë një ankesë tek Komisioni kompetent i qeverisë të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë brenda 8 (tetë) ditëve që nga data e marrjes të këtij vendimi. Vendimi i Komisionit kompetent të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë merret brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kësaj ankese. Kundër vendimit të komisionit kompetent, mund të fillohet një mosmarrëveshje administrative në një gjykatë kompetente në përputhje me të drejtën për mosmarrëveshjet administrative.

Një të huaji që i jepet një vendim për dhënien e qëndrimit të përkohshëm do t'i jepet një leje qëndrimi i përkohshëm nga Ministria e Punëve të Brendshme me të hyrë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Ministria e Punëve të Brendshme do t'i japë personalisht të huajit të interesuar një leje qëndrimi i përkohshëm. Leja e qëndrimit të përkohshëm i jep të drejtë të huajit për shumë hyrje dhe dalje nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë pa vizë deri sa të mbarojë leja e tij/saj e qëndrimit.

### ***Shtyrja e lejes së qëndrimit të përkohshëm***

Leja e qëndrimit të përkohshëm jepet për periudhën e nevojshme për të përmbushur qëllimin e qëndrimit, deri në një vit. Pas aplikimit e një të huaji, që duhet të dorëzohet maksimumi 30 (tridhjetë) ditë përpara mbarimit të lejes së tij/saj të qëndrimit, ajo mund të shtyhet me kusht nëse plotësohen kërkesat. Një i huaj që dorëzon një aplikim për shtyrje të lejes së qëndrimit të përkohshëm mund të qëndrojë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë derisa të jetë marrë vendimi përfundimtar për këtë aplikim. Ministria e Punëve të Brendshme do t'i japë këtij personi një dokument të veçantë që i jep të drejtën të qëndrojë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë derisa të merret vendimi për shtyrjen e kohëzgjatjes. Leja e qëndrimit të përkohshëm nuk do të shtyhet nëse përcaktohet që i huaji nuk ka qëndruar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për arsye të pajustificuara për një periudhë më të gjatë se një e treta e periudhës së vlefshmërisë së lejes së tij/saj të qëndrimit të përkohshëm.

### ***Arsyet për qëndrim të përkohshëm***

Leja e përkohshme për punësim, punë dhe vetëpunësim: leja e qëndrimit të përkohshëm për arsye punësimi, pune ose vetëpunësimi mund të jepet nëse i huaji i interesuar dorëzon një leje pune ose leje tjetër të nevojshme së bashku me aplikimin e tij/saj për qëndrim të përkohshëm përveçse kur marrëveshjet ndërkombëtare e ratifikojnë ndryshme. Leja jepet për një periudhë që i korrespondon periudhës së vlefshmërisë së lejes së punës, por maksimumi për një vit me mundësi për shtyrje.

Qëndrim i përkohshëm për qëllime të trajtimit mjekësor: Leja e qëndrimit të përkohshëm për qëllim trajtimi mjekësor mund të jepet nëse i huaji i interesuar së bashku me aplikimin e tij/saj për qëndrim të përkohshëm paraqet gjithashtu:

- Një recetë të lëshuar nga institucionet shëndetësore maqedonase që ofron trajtimin mjekësor që të përmbajë periudhën e këtij trajtimi si dhe trajtimin e mundshëm pas trajtimit mjekësor
- Një recetë të lëshuar nga institucionet shëndetësore maqedonase që konfirmon se pritja e të huajit për trajtim mjekësor nuk do të dëmtojë pacientët që janë shtetas maqedonas, dhe
- Një vërtetim që provon se fondet për këtë trajtim përballohen ose nga vetë i huaji ose vendi i tij/saj i origjinës

Leja e qëndrimit të përkohshëm për qëllim të trajtimit mjekësor jepet për një periudhë deri në një vit dhe mund të shtyhet sipas kushteve të lartpërmendura për shtyrjen e lejes së qëndrimit të përkohshëm. Me përfundimin e trajtimit mjekësor dhe pas mjekësor i huaji është i detyruar të largohet nga territori maqedonas.

Qëndrim i përkohshëm për arsye humanitare: Qëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare mund të jepet si përjashtim për një të huaj që nuk përmbush kushtet për dhënien e lejeve të qëndrimit të përkohshëm siç e përcakton ligji në rastet e mëposhtme:

- Nëse ka arsye për të dyshuar që ai/ajo është viktimë e një akti kriminal "trafikim i qenieve njerëzore" të përcaktuar në Kodin Penal,
- Nëse ai/ajo është nën 18 vjeç dhe nuk është i shoqëruar nga një prind apo kujdestar;
- Nëse është person pa shtetësi; ose
- Arsye të tjera të bazuara me natyre humanitare

Leja do të jepet për një periudhë deri në një vit dhe mund të shtyhet nëse ka arsye humanitare.

Qëndrimi i përkohshëm i viktimave të trafikut të qenieve njerëzore- një i huaj për të cilin ka arsye dyshimi se është viktimë e një akti kriminal "trafikim i qenieve njerëzore" siç përcaktohet në Kodin Penal, do të bëhet e mundur që në lidhje me mbrojtjen dhe asistencën e tij në procesin e rikuperimit dhe shmangien e ndikimit të kryesve të këtij krimi, të merret vendim brenda një periudhe 2 (dy) mujore. Brenda kësaj periudhe, viktima duhet të vendosë ose të bashkëpunojë me autoritetet kompetente në zbulimin e krimeve dhe kryesve të tyre, ose të kthehet në vendin shtetas rezident i ligjshëm i të cilit është ai/ajo. Për interesin e mirë të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore që janë të mitur nën 18 vjeç, periudha e qëndrimit mund të shtyhet. Periudha e qëndrimit mund të ndërpritet nëse:

- i huaji vullnetarisht, aktivisht, ose me iniciativën e tij rinovon kontaktet e tij/saj me të dyshuar të përfshirë në këtë krim, ose
- rendi publik dhe siguria kombëtare e ish Republikës së Maqedonisë e kërkojnë këtë gjë

Qëndrimi i përkohshëm për qëllime studimi (shihni seksionin 4 më lart)

## **Lejet e qëndrimit të përhershëm**

Leja e qëndrimit të përhershëm i jepet një të huaji që, përpara aplikimit të tij/saj për qëndrim të përhershëm, ka qëndruar në territorin e ish republikës jugosllave të Maqedonisë për një periudhë të pandërprerë minimumi 5 (pesë) vjeçare në bazë të lejes së përkohshme të qëndrimit. Kushti i periudhës së pandërprerë të qëndrimit 5 (pesë) vjeçar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë do të konsiderohet i përmbushur nëse brenda periudhës 5 (pesë) vjeçare përpara aplikimit për qëndrim të përhershëm i huaji nuk ka qëndruar jashtë territorit maqedonas për një periudhë të vazhdueshme prej 6(gjashtë) muajsh ose për një periudhë total që nuk kalon 10 (dhjetë) muaj.

### ***Kushtet për dhënien e lejeve të qëndrimit të përhershëm***

Ministria e Punëve të Brendshme i jep personalisht të huajit të interesuar lejen e qëndrimit të përhershëm.

Leja e qëndrimit të përhershëm i jepet një të huaji që:

- deri në momentin e aplikimit, qëndron në mënyrë të ligjshme në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për një periudhë të pandërprerë 5 (pesë) vjeçare në bazë të lejes për qëndrim të përkohshëm- shihni më lart
- ka mjete të qëndrueshme dhe të rregullta jetese,
- ka siguruar akomodim ose mjete akomodimi
- ka sigurim shëndetësor
- gjatë qëndrimit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë brenda një periudhë 5 (pesë) vjeçare përpara aplikimit për qëndrim të përhershëm ajo/ai nuk ka kryer krim të dënueshëm me minimumi 1(një) vit burg, dhe
- nuk përbën kërcënim për rendin publik, sigurinë kombëtare ose marrëdhëniet ndërkombëtare të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Leja e qëndrimit të përhershëm për qëllim punësimi, pune ose vetëpunësimi mund t'i jepet një të huaji që ka kualifikime ose arsim të lartë të nevojshëm për funksionimin e institucionit përkatës në ose autoritetin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë

Leja e qëndrimit të përhershëm bazuar në bashkimin familjar mund të jepet vetëm për anëtarë të afërm të familjes së një të huaji që ka marrë më përpara leje të përhershme qëndrimi me kusht që të jetojnë në martesë ose bashkim familjar. Një të huaji qëndrimi i të cilit është i rëndësishëm për interesat e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë mund t'i jepet një leje e përhershme qëndrimi përpara mbarimit të afatit kohor të përcaktuar.

Leja e qëndrimit të përhershëm nuk i jepet një të huaji që ka qëndruar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë bazuar në:

- leje qëndrimi të përkohshëm për qëllim të frekuentimit të shkollës ose studimeve,
- leje qëndrimi të përkohshëm për qëllim të pjesëmarrjes së programe ndërkombëtare të shkëmbimit të studentëve/nxënësve
- leje qëndrimi të përkohshëm për qëllim të specializimit, arsimit profesional ose trajnimit praktik
- leje qëndrimi të përkohshëm për qëllim të kërkimit shkencor
- leje qëndrimi të përkohshëm për qëllim të trajtimit mjekësor
- leje qëndrimi për arsye humanitare
- mbrojtje të përkohshme
- si refugjat ose aplikant për azil për aplikimin e të cilit nuk ka vendim përfundimtar në një procedurë të përcaktuar me ligj, dhe
- një status ligjor të rregulluar me Konventën e Vjenës 1961 për Marrëdhëniet Diplomatike, Konventën e Vjenës 1963 për Marrëdhënie Konsullore, ose Konventën e Vjenës për Përfaqësime të Shteteve në Marrëdhëniet e tyre më Organizatat Ndërkombëtare me natyrë universale

### ***Procedura për dhënien e lejeve të qëndrimit të përhershëm***

Leja e qëndrimit të përhershëm jepet pas aplikimit të një të huaji. I huaji i interesuar është i detyruar të dorëzojë një dokument të vlefshëm dhe të njohur udhëtimi ose fotokopjen e tij të noterizuar si dhe të provojë që ai i plotëson kushtet e mësipërme për dhënien e lejes, së bashku me aplikimin. Ministria e Punëve të Brendshme merr vendim për aplikimin për qëndrim të përhershëm.

## **6. Sistemi i azilit**

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë u jep të drejta azili kategorive të mëposhtme të personave:

- **Refugjatë** (refugjatë sipas Konventës 1951 që lidhet me statusin e refugjatëve dhe Protokollit 1967 në lidhje me statusin e refugjatëve)- refugjat është një i huaj që për shkak të frikës së bazuar për përndjekje për arsye race, feje, kombësie, anëtarësia në grupe të caktuara sociale ose bindje politike, është jashtë shtetit të kombësisë së tij dhe nuk mundet, ose për shkak të kësaj frike, nuk dëshiron të vihet nën mbrojtjen e atij shteti; ose që duke mos pasur kombësinë dhe duke qenë jashtë shtetit ku ka pasur vendin e zakonshëm të qëndrimit nuk mundet, ose për shkak të kësaj frike, nuk dëshiron të kthehet atje
- **persona nën mbrojtje humanitare** (në përputhje me nenin 3 të konventës 1950 për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe nenin 3 të Konventës 1984 kundër torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues)- Një person nën mbrojtje humanitare është një i huaj të cilit ish Republika Jugosllave e Maqedonisë i jep të drejtën e azilit për arsye humanitare dhe i jep leje të qëndrojë brenda territorit të saj për shkak se ai/ajo do t'i nënshtrohej torturës, trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues në shtetin e kombësisë së tij, ose kur, duke mos pasur kombësi, ai ka vendin e qëndrimit të zakonshëm.

### **Procedura**

Një azil kërkues sipas ligjit maqedonas është një i huaj që kërkon mbrojtje nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë nga dita që ai/ajo i është drejtuar Ministrisë së Brendshme deri në ditën e marrjes së vendimit përfundimtar në procedurën për njohjen e të drejtës së azilit. Nëse kjo përgjigje është pozitive, ai/ajo bëhet refugjat. Një azilkërkues duhet të aplikojë për njohjen e së drejtës së azilit kur të hyjë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Kërkesa i deklarohet policisë në pikën e kalimit të kufirit ose në rajonin më të afërt policor. Rajoni i policisë është i detyruar të sigurojë shoqërim për azilkërkuesin për në seksionin për azilin, ku ai/ajo do të dorëzojë aplikimin për azil.

Një azilkërkues që ka hyrë në mënyrë të paligjshme ose që ka qëndruar në mënyrë të paligjshme në territorin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe vjen direkt nga një shtet ku jeta e tij ose liritë e tij janë kërcënuar nuk do të ndëshkohet nëse ai/ajo aplikon menjëherë për njohje të së drejtës së azilit tek seksioni për azilin ose paraqitet tek rajoni më i afërt i policisë dhe jep shpjegime për aplikimin e tij/saj për njohjen e të drejtës së azilit, si dhe arsye të vlefshme për hyrjen dhe qëndrimin e tij të paligjshëm.

Aplikimi për azil dorëzohet me shkrim ose gojarisht (i shënuar në procesverbal) në gjuhën maqedonase, ose nëse nuk është e mundur në gjuhën e vendit të origjinës ose në gjuhë tjetër të huaj me përdorim të zakonshëm. Ndërsa dorëzon një aplikim për azil, azilkërkuesi duhet të fotografohet dhe t'i merren shenjat e gishtërinjve. Ndërsa dorëzon një aplikim për azil, seksioni për azilin i jep azilkërkuesit një vërtetim të vulosur me një numër dhe datë dorëzimi.

Nëse azilkërkuesi ka dokumente, këto duhet t'i bashkëngjiten aplikimit kur janë të nevojshme për procedurën e njohjes së të drejtës së azilit dhe në veçanti:

- dokument udhëtimi;
- viza, leje qëndrimi ose dokumente të tjera të ngjashme;
- kartë identiteti ose dokumente të tjera identifikimi;
- një certifikatë personale dhe martese (nëse është e mundur);
- bileta udhëtimi dhe të ngjashme, si dhe
- dokumente të tjera që mund të jenë të rëndësishme në procedurën e njohjes së të drejtës së azilit.

Dokumentet mbahen në Seksionin për Azilin gjatë procedurës së njohjes së të drejtës për azil dhe azilkërkuesit i jepen fotokopje të dokumenteve të dorëzuara dhe një vërtetim që dokumentet origjinale janë tek seksioni për azilin.

### **Vendimmarrja dhe llojet e vendimeve**

Në bazë të fakteve dhe provave të krijuara gjatë procedurës, seksioni për azilin merr vendim për të njohur statusin e refugjatit, një vendim për të njohur statusin e një personi në mbrojtje humanitare, ose një vendim që refuzon aplikimin për njohjen e të drejtës për azil. Vendimi me anë të të cilit një aplikim për azil refuzohet përcakton arsyet, për të cilat nuk është pranuar aplikimi, këshilla për zgjidhje/mjete ligjore dhe afatin kohor brenda të cilit personi është i detyruar të largohet nga territori i Republikës së Maqedonisë që nuk mund të jetë më pak se 15 ditë nga dita kur vendimi hyn në fuqi.

### **Të drejtat e azilkërkuesve**

Gjatë procedurës së vendimmarrjes për njohjen e të drejtës për azil, azilkërkuesit kanë të drejtë për:

- qëndrim
- akomodim dhe kujdes në një qendër pritjeje ose vend tjetër akomodimi të caktuar nga Ministria e Punës dhe Politikave Sociale;
- shërbime bazë shëndetësore;
- punë vetëm brenda qendrës së pritjes ose vendi tjetër akomodimi të caktuar nga Ministria e Punës dhe Politikave Sociale; dhe
- komunikim me Komisionerin e Lartë për Refugjatë, si dhe organizata humanitare jo qeveritare për qëllim sigurimin e ndihmës ligjore gjatë procedurës për njohjen e të drejtës për azil.

Ministria e Punës dhe Politikave sociale kujdeset për sigurimin e mjeteve të jetesës dhe kujdesin shëndetësor për azilkërkuesit ndërsa ata ndodhen në qendrën e pritjes ose vend tjetër akomodimi të caktuar nga Ministria.

### **Të drejtat e azilkërkuesve të miratuar**

- status personal dhe të drejtën e qëndrimit
- akomodim
- ndihmë financiare
- të drejtën për kujdes shëndetësor
- të drejtë për të punuar dhe të drejta për sigurime shoqërore

Një refugjat ka kryesisht të drejta të njëjta si shtetasit maqedonas përveçse të drejtën e votës, themelimit dhe anëtarësisë në organizatë politike; ata nuk mund të praktikojnë një profesion; angazhohen në punësim fitimprurës, ose themelojnë shoqërinë e shtetasve ose partive politike në rast kur, si kusht, përcaktohet me ligj që personi duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.

## 7. Bashkimi familjar

Qëndrimi i përkohshëm për qëllim të bashkimit familjar:

Një i huaj që ka një leje qëndrimi të përhershëm ose qëndrimi të përkohshëm një vjeçare për qëllime të punësimit, punës ose vetëpunësimit ose një i huaj që është nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë me origjinë, i jepet e drejta për bashkim familjar me anëtarët e familjes të tij/saj të afërm që janë të huaj sipas kushteve të mëposhtme:

***Anëtar i afërm i familjes, do të thotë një i huaj që:***

- Është bashkëshort/e e të huajit në fjalë,
- Është fëmijë i mitur i të huajit ose bashkëshortes/bashkëshortit të tij/të saj përfshirë këtu dhe fëmijët e adoptuar ose fëmijët e mitur të bashkëshortit/bashkëshortes të tij/saj që janë nën kujdesin e të huajit ose bashkëshortit/bashkëshortes të tij/saj me një vendim gjyqësor ose vendim nga vendi ku është bërë adoptimi apo është marrë kujdestaria si dhe siç është certifikuar nga një autoritet kompetent maqedonas. Fëmijë të mitur duhet të jenë në moshë mbi 18 vjeç dhe të pamartuar. .

Si përjashtim, anëtarë të familjes do të konsiderohen dhe

- të afërm të parë të të huajit ose bashkëshortes/bashkëshortit të tij në rastin e personave në ngarkim që nuk gëzojnë mbështetje të duhur familjare në vendin e banimit
- fëmijët e të huajit ose bashkëshortes/bashkëshortit të tij/saj që janë në moshë ligjore por që nuk janë të martuar dhe nuk mund të kujdesen për nevojat e tyre për shkak të arsyeve shëndetësore dhe prindërit e një fëmije të mitur nëse kjo është për interesat më të mira të fëmijës

***Të drejtat e anëtarëve të afërm të familjes***

Një anëtar i afërm i familjes së një të huaji që ka leje qëndrimi të përkohshëm në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka të drejtë për arsim, formim profesional, punësim dhe vetëpunësim.

***Kushtet për dhënien dhe vlefshmërinë e lejes***

Aplikimi për qëndrim të përkohshëm për anëtarë të afërm të familjes mund të dorëzohet nga i huaji që ka një leje qëndrimi maqedonase tek Ministria e Punëve të Brendshme.

I huaji është i detyruar të dorëzojë sa më poshtë së bashku me aplikimin:

- qëndrimin e tij/saj në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë,
- marrëdhëniet e tij/saj familjare
- mjete të qëndrueshme dhe të rregullta jetese të mjaftueshme për atë dhe të afërmit e tij familjarë që synojnë të qëndrojnë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë
- akomodim të sigurt për anëtarët e tij/saj të afërm të familjes,
- sigurim personal shëndetësor si dhe sigurim shëndetësor për anëtarët e tij/saj të afërm të familjes, dhe
- fotokopje të noterizuara të dokumenteve të tyre të udhëtimit

Në rastin e aplikimit për qëndrim të përkohshëm për fëmijët e mitur të të huajit ose bashkëshortes/bashkëshortit të tij/saj dhe të drejtës së përbashkët prindërore, së bashku me aplikimin, i huaji në fjalë duhet të dorëzojë miratimin e prindit tjetër të legalizuar nga një autoritet kompetent në shtetin ku qëndron prindi tjetër.

Një anëtar i të afërmit të familjes së një të huaji që ka leje qëndrimi të përkohshëm në Maqedoni i jepet një leje qëndrimi të përkohshëm me vlefshmëri deri në një vit dhe mund të shtyhet për periudhën korresponduese të lejes së të huajit.

Një anëtar i të afërmit të familjes së një të huaji që ka leje qëndrimi të përhershëm në Maqedoni i jepet një leje qëndrimi të përkohshëm me vlefshmëri deri në një vit dhe sipas kushteve të përcaktuara në ligj, mund të shtyhet deri në plotësimin e kërkesave për qëndrim të përhershëm.

Leja nuk do të shtyhet nëse rast se:

- i huaji dhe anëtarët e tij/saj të afërmit të familjes nuk bashkëjetojnë në një martesë ose bashkim familjar, dhe
- Ka dyshime që martesa me të huajin që ka leje qëndrimi në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ose adoptimi apo kujdestaria mbi fëmijë të mitur janë bërë me kontratë.

## 8. Sistemi i kujdesit shëndetësor

Sistemi maqedonas i kujdesit shëndetësor përfshin dy lloje sigurimesh shëndetësore: sigurimi shëndetësor i detyruar dhe vullnetar. Sigurimet shëndetësore të detyruara janë sipas juridiksionit të fondit të shtetit për sigurimin shëndetësor. Sigurimet shëndetësore vullnetare zbatohen nga kompanitë e sigurimeve të krijuara sipas ligjit për sigurimet.

Për më shumë informacion ju lutemi të shihni: <http://www.fzo.org.mk/index.htm>  
<http://www.rzzz.org.mk/>

## 9. Sistemi i sigurimeve shoqërore

Sistemi social në Maqedoni është nën juridiksionin e sektorit për mbrojtje sociale në Ministrinë e Punës dhe Politikave Sociale. Departamenti për mbrojtjen sociale është përgjegjës për sistemin, organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e mbrojtjes sociale, standardin e jetesës së popullsisë, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, kujdestarinë dhe adoptimin, mbrojtjen e invalidëve socialë, mbrojtjen e refugjatëve, personave të shpërngulur, dhe azilkërkuesve, krimet e të miturve, dhe sjelljen shoqërore të fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të veçanta të personave që janë të përjashtuar nga shoqëria, kontrollin mbi punën e institucioneve shtetërore publike dhe private për mbrojtjen sociale, bashkëpunimin me OJQ në ofrimin e shërbimeve sociale për njerëzit.

Njësitë e Departamentit brenda sektorit për mbrojtje sociale janë:

- Departamenti për mbrojtjen sociale të familjes dhe mbrojtjen ligjore të fëmijëve dhe familjes
- Departamenti për mbrojtjen e personave me paaftësi fiziologjike, mbrojtjen e të moshuarve,
- Departamenti për strehimin e personave nën mbrojtje humanitare- refugjatë, azilkërkues, persona të shpërngulur brenda vendit, migrantë, persona të kthyer sipas marrëveshjeve të ripranimit
- Departamenti për të siguruar realizimin e të drejtave të mbrojtjes sociale
- Departamenti për institucione publike dhe private për mbrojtjen sociale
- Departamenti për mbrojtjen sociale dhe strehimin e personave të përjashtuar nga shoqëria

Kontakti i personelit përgjegjës për Sektorin e Mbrojtjes Sociale:

Drejtor: Zihra Memeti  
tel: 02/ 3 106 660  
e-mail: [zmemeti@mtso.gov.mk](mailto:zmemeti@mtso.gov.mk)  
Ndihmës drejtor: Sofija Spasovska  
tel: 02/ 3 106 660  
e-mail: [sspasovska@mtsp.gov.mk](mailto:sspasovska@mtsp.gov.mk)

## 10. Strehimi

### **Adriatik**

Str. Naroden front 33  
Phone: +389 2 112 776, +389 2 3216 994  
<http://www.adriatik93.com.mk/>

### **Astorija**

Phone: +389 2 3110 566, +389 2 3139 068, +389 2 3139 072, Fax: +389 2 3121 030  
[www.reatletste.com.mk](http://www.reatletste.com.mk)

### **Bastion**

Blvd. Kliment Ohridski 66/1/3  
Phone: +389 2 3216 246, +389 2 3124 127  
[www.bastion.com.mk](http://www.bastion.com.mk)

### **Dom-Dizajn**

Str. Nikola Trimpare 15, Phone: +389 2 3111 544, 3239 703  
<http://www.dom-design.com.mk/>

### **NEW WAY Ltd.**

Gradski zid block 9 shop 2a, 1000 Skopje, Macedonia  
phone: +389 2 3109 358; fax: +389 2 3128 668  
e-mail: [realestate@newway.com.mk](mailto:realestate@newway.com.mk)  
Façe interneti: [www.newway.com.mk](http://www.newway.com.mk)

### **Renesans**

Phone/Fax: +389 2 3134 504  
[www.renesans.com.mk](http://www.renesans.com.mk)

## 11. Njohja e diplomave

**Ligji për Arsimin e Lartë** merret me njohjen e diplomave të fituara jashtë. Qendra e Informacionit për ekuivalentimin dhe njohjen e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë është organ brenda Ministrisë së Arsimit që ndihmon mbajtësit e diplomave të huaja për njohjen e kualifikimeve të tyre në Maqedoni. Kjo Qendër vlerëson llojin dhe nivelin e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë dhe e krahason me kualifikime të arsimit të lartë që mund të merren në institucione maqedonase të arsimit të lartë. Barazia vlerësohet në përputhje me tre cikle kualifikimi të parashikuara në procesin e Bolonjës brenda fushës europiane të arsimit të lartë.

Maqedonia nënshkroi gjithashtu Konventën Europiane për Ekuivalentimin e Periudhës së Studimeve Universitare 16- të Parisit 15. XII. 1956.

Disa prej pikave kryesore të Konventës nga viti 1956 janë që shtetet që kanë ratifikuar këtë konventë njohin një periudhë studimi të kryer në një universitet në një shtet tjetër anëtar të Këshillit të Europës si ekuivalente me një periudhë të ngjashme studimi të kryer në

universitetin e vendit të origjinës (Neni 2); përcaktimi i kushteve sipas të cilave një provim i marrë ose një lëndë e marrë nga studenti gjatë periudhës së studimit në një universitet të një vendi tjetër anëtar të Këshillit të Europës mund të konsiderohet ekuivalent me një provim të ngjashëm të marrë ose një lëndë të marrë nga një student në universitetin e tij/saj të origjinës (neni 3). Por Konventa Europiane për Ekuivalentimin e Studimeve Universitare zbatohet për fushën në gjuhët moderne.

## 12. Shërbime mbështetëse për migrantët

- **Organizata Ndërkombëtare për Migracion Shkup-** Misioni IOM në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë punon në nivele të ndryshme të menaxhimit të migracionit, duke trajtuar sfida të ndryshme të migracionit dhe duke ofruar asistencë- mes të tjerash- për migrantët dhe migrantët e ardhshëm, institucionet qeveritare, shoqërinë civile dhe grupet e kërcënuara sociale. Programi IOM është hartuar për të siguruar migracion të rregullt dhe njerëzor, përfshirë këtu, por pa u kufizuar, fusha të ndërtimit të kapaciteteve për menaxhimin e migracionit, kthimin dhe riintegrimin, antitrafikimin, menaxhimin e kufijve, stabilizimin komunitar dhe zhvillimin social ekonomike dhe asistencë shëndetësore <http://www.iomskopje.org.mk/>
- **Komisioni Kombëtar Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit të Parregullt** <http://www.nacionalnakomisija.gov.mk/>
- **Porta e Hapur – La Strada** Maqedonia është organizatë jo qeveritare jo fitimprurëse e regjistruar në shtator 2000, që punon për parandalimin dhe mbështetjen psikologjike dhe sociale që u jepet viktimave të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore. Në organizatë punojnë 18 gra me profesione të ndryshme si punonjëse sociale, psikologe, avokate, gazetarë, ekonomiste, etj - <http://www.lastrada.org.mk/eng/info.htm>
- **Për fëmijëri të lumtur “For Happy childhood”** është organizatë jo qeveritare qëllimi i së cilës është të ofrojë mbështetje për individë (fëmijë, të rinj dhe gra) dhe grupe (familje) në rrezik të ndryshëm, sidomos rrezik për dhunë (sek, trafikim), duke organizuar trajnime për vullnetarë dhe profesionale që punojnë me grupe në rrezik [http://www.happy-childhood.com.mk/happy\\_childhood.htm](http://www.happy-childhood.com.mk/happy_childhood.htm)
- **Rrjeti sektorial i OJO kundër trafikimit –** Maqedonia <http://www.antitrafficking-partners.org.mk/english/indexen.asp>
- **Ministria e Punës dhe Politikave Sociale e Republikës së Maqedonisë –** Mekanizmi Kombëtar i Referimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore
- **Kurse në gjuhën maqedonase për të huajt** [http://www.csglobal.com.mk/index.php?option=com\\_content&task=view&id=71&Itemid=82](http://www.csglobal.com.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=71&Itemid=82)
- **Shkolla e anglishtes St George's** është një nga shkollat më të mëdha dhe më të suksesshme të gjuhës angleze në Republikën e Maqedonisë. Shkolla ST George's organizon gjithashtu kurse për gjuhën maqedonase. <http://stgeorgemk.com.mk/courses.html>

## 13. Marrja e shtetësisë/kombësisë

Ligji për shtetësinë- Maqedonia, Neni 1

“Ky nen rregullon mënyrën dhe kushtet e fitimit dhe përfundimit të shtetësisë të Republikës së Maqedonisë, vendosjen e shtetësisë, autoritetin publik kompetent për zgjidhjen e këtyre

çështjeve, certifikimin e shtetësisë dhe mbajtjen e të dhënave të shtetasve të Republikës së Maqedonisë”

#### Marrja e shtetësisë- Neni 3

Shtetësia e Republikës së Maqedonisë merret nëpërmjet:

1. origjinës
2. lindjes brenda territorit të Republikës së Maqedonisë
3. natyralizimit dhe
4. traktateve ndërkombëtare.

Teksti i plotë i Ligjit për Shtetësinë i Republikës së Maqedonisë:

<http://www.legislationline.org/legislation.php?tid=11&lid=2197>

## **14. Informacion tjetër me kontakte të rëndësishme**

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë [http://www.vlada.mk/english/index\\_en.htm](http://www.vlada.mk/english/index_en.htm)
- Ministria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë <http://www.mfa.gov.mk/default.aspx?ItemID=238>
- Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Maqedonisë: <http://www.mfa.gov.mk/default1.aspx?ItemID=315>
- Ministria e Arsimit e Republikës së Maqedonisë <http://www.mon.gov.mk/en/home>